

VENDIM
Nr. 300, datë 17.5.2024

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E MINISTRISË SË MBROJTJES,
MIRATUAR PËR VITIN 2024, NGA FONDI REZERVË I KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, PËR MODERNIZIMIN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Mbrojtjes, në buxhetin e miratuar për vitin 2024, në artikullin 231, “Shpenzime kapitale”, në programin buxhetor “Forcat e luftimit”, i shtohet fondi prej 1 504 000 000 (një miliard e pesëqind e katër milionë) lekësh për modernizimin e Forcave të Armatosura.
 2. Fondi sipas pikës 1, të këtij vendimi, prej 1 504 000 000 (një miliard e pesëqind e katër milionë) lekësh, përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i miratuar për vitin 2024.
 3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama